



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.103

6 gusht

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.553, datë 7.7.2010	Për përcaktimin e sezonit të gjetisë në Republikën e Shqipërisë	5207
Vendim i KM nr.568, datë 14.7.2010	Për hapjen e programit të studimeve, të ciklit të parë “Teknologji informacioni dhe komunikimi”, në Universitetin e Tiranës	5207
Vendim i KM nr.569, datë 14.7.2010	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Surroj të qarkut të Kukësit	5208
Vendim i KM nr.570, datë 14.7.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Frashër të qarkut të Gjirokastrës	5209
Vendim i KM nr.571, datë 14.7.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i segmentit rrugor që bashkon rrugën “Sali Llani” me rrugën “Dervish Hima”, në bashkinë e Burrelit ...	5210
Vendim i KM nr.573, datë 14.7.2010	Për trajtimin me ushqim, pa pagesë, të efektivave të Gardës së Republikës	5211
Vendim i KM nr.574, datë 14.7.2010	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”, të ndryshuar	5212
Vendim i KM nr.575, datë 14.7.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Qendër Piskovë të qarkut të Gjirokastrës	5213

Vendim i KM nr.582, datë 14.7.2010	Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, Republikës së Kosovës, të një prone	5214
Udhëzim i MD dhe PP nr.5, datë 21.7.2010	Për përcaktimin e rregullave mbi formën e letërkërkesës, procedurën dhe përkthimin e akteve	5217
Vendim i BSH nr.48, datë 14.7.2010	Për miratimin e rregullores “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore”	5219
Vendim i BSH nr.49, datë 14.7.2010	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarive shtesë nga Banka Raiffeisen sh.a.....	5229
Kërkesë e MPPT nr.326/1, datë 21.1.2010	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e Re Tiranë” (Fabrika e Bukës–Doganë)	5230
Kërkesë e MPPT nr.4086, datë 6.7.2010	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private tokë, arë dhe truall, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By pass Plepa-Kavajë Rrogozhinë” lotet 6,7.....	5233
Kërkesë e MPPT nr.3816/2, datë 9.7.2010	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë, truall dhe objekte) që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Porto Romano-Durrës”, loti i parë.....	5236

VENDIM
Nr.553, datë 7.7.2010

PËR PËRCAKTIMIN E SEZONIT TË GJUE TISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 33 të ligjit nr.10253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sezoni i gjuetisë, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, hapet më 1 tetor dhe mbyllet më 15 shkurt. Vetëm për llojet shkurtë (*Coturnix coturnix*) dhe turtull (*Streptopelia turtur*), sezoni hapet më 15 gusht, ndërsa për llojin rosë marsatore (*Anas querquedula*), sezoni mbyllet më 15 mars.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe drejtoritë përkatëse të shërbimit pyjor, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.568, datë 14.7.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE, TË CIKLIT TË PARË “TEKNOLOGJI INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI” NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Universitetin e Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të parë, “Teknologji informacioni dhe komunikimi (me drejtim teknologji informacioni)”. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në “Teknologji informacioni dhe komunikimi (me drejtim teknologji informacioni)”.

2. Programi i studimeve të ciklit të parë realizohet me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tri) vite akademike.

3. Programi i studimeve “Teknologji informacioni dhe komunikimi (me drejtim teknologji informacioni)” fillon veprimtarinë e vet në vitin akademik 2010 – 2011.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.569, datë 14.7.2010

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS SURROJ TË QARKUT TË KUKËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Surroj të qarkut të Kukësit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 793 (shtatëqind e nëntëdhjetë e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Surroj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Surroj

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-6,267,271,621	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
9,264,272	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
7,270,620	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
8,259,273	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
11-13,303,304,308-310,625-627	Varrezat publike	Në pronësi
216-246	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
34,35,37,38,40,41,43,392-604	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
36,39,42	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
14-26,262,263,268,269,275	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi

VENDIM
Nr.570, datë 14.7.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS FRASHËR TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Frashër të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Frashër të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.240, datë 25.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Frashër të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Frashër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Frashër

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
25	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
31-34	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore.	Në pronësi
35-44	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
45-48	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
49-51	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
54-63	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
64-72	Varrezat publike	Në pronësi
116-124	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
135-138	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM
Nr.571, datë 14.7.2010

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I
SEGMENTIT RRUGOR QË BASHKON RRUGËN “SALI LLANI” ME RRUGËN
“DERVISH HIMA” NË BASHKINË E BURRELIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i segmentit rrugor që bashkon rrugën “Sali Llani” me rrugën “Dervish Hima”, në bashkinë e Burrelit.

2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Burrelit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, sipas masës përkatëse, paraqitur në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqet 38 (tridhjetë e tetë) m² truall dhe 38 (tridhjetë e tetë) m² objekt, pronë private, në masën 2 173 923 (dy milionë e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzet e tre) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Burrelit, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Burrelit.

7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Burrelit për realizimin e këtij projekti.

8. Regjistrimi i ri i pasurive 38 (tridhjetë e tetë) m² truall dhe 38 (tridhjetë e tetë) m² objekt, shpronësuar në favor të bashkisë së Burrelit, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Burrelit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS QË BASHKON RRUGËN “SALI LLANI” ME RRUGËN “DERVISH HIMA” NË BASHKINË E BURRELIT

Nr.	Emër mbiemër	Sip. truall m²	Çmimi lekë/m²	Vlera lekë	Dokument pronësie	Zona kadastrale
1	Ramazan Doksani	38	3900	148200	Certifikatë pronësie	1326
	Shuma	38		148200		
	Emër mbiemër	Sip. objekti m²	Çmimi lekë/m²	Vlera lekë	Dokument pronësie	Zona kadastrale
2	Ramazan Dosksani	38	53308	2025723	Certifikatë pronësie	1326
	Shuma	38		2025723		
	Totali			2 173 923		

**VENDIM
Nr.573, datë 14.7.2010**

**PËR TRAJTIMIN ME USHQIM, PA PAGESË, TË EFEKTIVAVE TË GARDËS
SË REPUBLIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “g” të pikës 2 të nenit 39 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Trajtimin me ushqim, pa pagesë, të efektivave të Gardës së Republikës, sipas mënyrës dhe kategorive të poshtëshënuara:

a) Me një vakt (drekë) ushqim, efektivat që shërbejnë në strukturat operuese të Gardës së Republikës.

b) Me tri vakte ushqim, njësia e ndërhyrjes së shpejtë, grupet e gatshme, të cilave, për natyrë të veçantë pune, shërbimi u zgjat më shumë se koha normale e punës.

c) Me tri vakte, i gjithë efektiv i Gardës së Republikës, për rastet e kalimit në gatishmëri.

2. Strukturat, numri sipas strukturave dhe normat e trajtimit me ushqim, për çdo vakt, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Brendshëm.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme.

4. Vendimi nr.256, datë 13.6.1994 i Këshillit të Ministrave “Për rritjen e normës së trajtimit ushqimor të kompanisë operative në Gardën e Republikës”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Komandanti i Gardës së Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

VENDIM
Nr.574, datë 14.7.2010

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 722, DATË 19.11.1998 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË
URBANISTIKËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ky ndryshim dhe shtesë:

1. Pika 132 e kreut III ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ 132. a) Sipas përcaktimit dhe klasifikimit të bërë në nenin 2 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, në rrugët e kategorisë “A”, autostrada, të kategorisë “B”, rrugë interurbane kryesore dhe të kategorisë “C”, rrugë interurbane dytësore, nuk lejohen hyrje-daljet, përveç atyre të përcaktuara në projektin e rrugës.

b) Ndalohet çdo lloj ndërtimi, me përjashtim të pikave të karburantit, në një distancë jo më të vogël se:

i) 30 metra nga kufiri rrugor i rrugëve të kategorisë “A”;

ii) 25 metra nga kufiri rrugor i rrugëve të kategorive “B” dhe “C”;

Pikat e karburantit vendosen në një distancë jo më të vogël se 10 m nga kufiri rrugor i rrugëve të kategorive “A”, “B” dhe “C”.

Në këtë kuptim, “kufi rrugor” konsiderohet fundi i pronësisë rrugore, referuar titujve të pronësisë dhe/ ose brezave të shpronësimit sipas projektit të miratuar.

Në mungesë të tyre, kufiri formohet nga vija e jashtme e hendekut të sigurimit të kanalit, kur ai ekziston, ose përkatësisht nga vija e sipërme/e poshtme e skarpatës, nëse rruga shtrihet në terren të pjerrët.”.

2. Në fund të pikës 135 të kreut III, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për të gjitha ndërtimet përgjatë rrugëve urbane që ndërlidhin autostradat apo rrugët interurbane kryesore e dytësore (unazat e jashtme dhe/ose rrugët hyrëse në qendrat urbane), përpara miratimit të lejes së sheshit të ndërtimit, subjekti duhet të pajiset me formularin 1/1 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, së bashku me projektin teknik për hyrje-daljen e autorizuar, i cili miratohet nga enti përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e autostradave dhe rrugëve interurbane kryesore e atyre dytësore.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.575, datë 14.7.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS QENDËR PISKOVË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Piskovë të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qendër Piskovë të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.1238, datë 10.9.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Qendër Piskovë të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qendër Piskovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Qendër Piskovë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-11,13-24	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
27-31	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
32-47,50-60,62-67	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
48,49,61,68-71,76-80	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
72,73	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
75	Prona që përdoren për shërbime sociale.	Në pronësi
81-174,175-184	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
186,187	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
227,229,250,252	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
262,263,269,270	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi

VENDIM
Nr.582, datë 14.7.2010

PËR KALIMIN NË PRONËSI, PA SHPËRBLIM, REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
TË NJË PRONE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 4 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, pa shpërblim, Republikës së Kosovës, të pronës, truall dhe ndërtesë, vila nr.6, rruga “Donika Kastrioti”, Tiranë, sipas certifikatës së pronësisë dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Prona kufizohet:

- në veri, me pasurinë 3/29,
- në jug, me pasurinë 3/212; 3/213,
- në lindje, me pasurinë 3/42,
- në perëndim, me pasurinë 3/254.

2. Kalimi i pronësisë bëhet për selinë e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Kosovës, në Tiranë, sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME TIRANE
Adresa: Rr: "Jordan Misja" Tirane

VERTETIM

NGA DOKUMENTET HIPOTEKOR

Vertetohet se ne Regjistrin Hipotekor me Nr. 555 Date 26 / 09 / 2008 figura e regjistruar ne pronesi te :

EMRI

ATESIA

MBIEMRI

PJESA

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NE PERGJEGJESI ADMINISTRIM

DREJTORIA E SHERBIMIT TE TRUPIT DIPLOMATIK

Pasuria me Nr 3/258 e ndodhur ne Zonen Kadastrale 8270 me Sip 1607,5 m² ne adresen: TRUALL ME SIPERFARJE 1607,5 MBI TE CILEN ESATE NJERITUAR NJE NJERTESE TREKATESHE:
KATI PEROME 353.704², KATI I PARE 376.5 m², KATI I DYTE 376.5 m²

Kufizimet e Pasurise jane :

V

L

P

Origjina e regjistrimit te pasurise se paluajtshme :

Nr .Hip 531 , dt 12 / 09 / 2008

Nr .Hip 779 , dt 22 / 09 / 2006 VERI

Nr .Hip _____ , dt _____ / _____ / _____

Nr .Hip 782 , dt 22 / 09 / 2006

Barre mbi pasurine NUK KA


Komente nga regjistruesi _____

Ky vertetim eshte i vlefshem i shoqeruar me Harten Treguese Provizore

Ky formular miratohet per vertetimin e pronesise deri ne perfundimin e Regjistrimit Fillestar sipas Ligjit Nr 7843, date 13/07/1994

Date 26 / 09 / 2008

Vertetimi i pronesise leshohet sipas kerkeses Nr 601 , dt 18 / 09 / 2008 , paraqitur pranë ZRPP Tirane



**ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME**

TIRANE

REGJISTRUESI

DORINA STRINGA



A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 2270 NR. IPASURISE 3/253 Vol. 40 Fq. 5

INDEKSI I HARTES 72 E-11 SHKALLA 1:500

ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANE Q/F TIRANE

Rr/L ANIL KOSTIOTI G Sh K Ap

B. KUFIZIMET

V. _____
L. _____
J. _____
P. _____

C. PRONARIET

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NE FOTOKOPJET E HARTES
JEST. SHKED. TIRANE

D. Data: 26/09/2003, Ora: 5:15:00



UDHËZIM
Nr.5, datë 21.7.2010

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE MBI FORMËN E LETËRKËRKESËS,
PROCEDURËN DHE PËRKTHIMIN E AKTEVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 7 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të germës “gj” të pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr.8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 5 të paragrafit 3 të ligjit nr.10 193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, Ministri i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm

UDHËZOJNË:

1. Rregullat e parashikuara në këtë udhëzim zbatohen nga prokuroria, gjykata dhe organe të tjera të përfshira në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në veprimtarinë e tyre administrative në kuadër të transmetimit të letërkërkesave, për aq sa nuk bien në kundërshtim me marrëveshjet shumëpalëshe ose dypalëshe në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, si dhe me legjislacionin në fuqi.

2. Në zbatim të këtij udhëzimi, letërkërkesat kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr.10 193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”.

3. Letërkërkesat vendase paraqiten me shkrim dhe duhet të përmbajnë:

a) Gjykatën ose prokurorinë që ka lëshuar letërkërkesën dhe adresën e tyre, si dhe emrin e personit të kontaktit me adresën e e-mail-it, numrin e telefonit dhe faksin. Gjykata/prokurori që lëshon letërkërkesën shënon edhe emrin e organit të huaj nëse është në dijeni të tij. Kur nuk është e mundur të identifikohet organi konkret të cilit i drejtohet letërkërkesa, shënohet vetëm emri i shtetit të kërkuar.

b) Emërtesën e saktë të llojit të letërkërkesës “letërporosi”, “kërkesë për ekstradim”, “kërkesë për njohje dhe ekzekutim të vendimeve gjyqësore të huaja”, “kërkesë për transferim të procedimeve penale” dhe “kërkesë për transferim të personave të dënuar”; si dhe arsyen për të cilën gjykata/prokurori ka vlerësuar për paraqitjen e kësaj kërkesë, duke cituar edhe nenet e aktit ndërkombëtar që i referohet, Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit nr.10193/2009;

c) Gjeneralitetet e personave të përfshirë në objektin e letërkërkesës, duke përfshirë sidomos shtetësinë, vendqëndrimin (edhe adresën nëse është në dijeni) dhe pozitën procedurale që ata kanë në procedimin penal;

ç) të dhëna mbi ecurinë e procedimit penal mbi mënyrën e regjistrimit (me kallëzim, kryesisht apo me ankim), si dhe fazën ku gjendet procedimi;

d) Një përshkrim të faktit penal, duke treguar kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, cilësimin juridik (edhe ndryshimet nëse ka pasur) të veprës penale të shoqëruar me kopje të tekstit të dispozitave ligjore që tregojnë cilësimin juridik të veprës penale dhe burimin e tyre (Kodi Penal apo ligji i veçantë);

dh) Shënimin “Urgjent” në krye të letërkërkesës, duke saktësuar në përmbajtje shkakun e urgjencës;

e) Afatin brenda të cilit nevojitet ekzekutimi dhe shkakun pse nevojitet respektimi i këtij afati;

ë) Aktet e procedimit penal që kanë lidhje dhe ndihmojnë ekzekutimin e letërkërkesës, duke i evidentuar në një listë. Dosjet dhe dokumentet i bashkëlidhen letërkërkesës vetëm në kopje të njësuara me origjinalin.

f) Çdo informacion tjetër, që mund të jetë me rëndësi për procedurën e ekzekutimit të letërkërkesës.

4. Letërkërkesa paraqitet në Ministrinë e Drejtësisë e nënshkruar nga gjyqtari/prokurori që ka lëshuar letërkërkesën, si dhe nga kryetari i gjykatës/drejtuesi i prokurorisë. Letërkërkesa e lëshuar nga prokurori, paraqitet në Ministrinë e Drejtësisë nga drejtuesi i prokurorisë së rrethit nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm. Letërkërkesa i paraqitet Ministrisë së Drejtësisë në tri kopje, njëra prej të cilave qëndron në Ministrinë e Drejtësisë, ndërsa dy të tjerat i përcillen përkatësisht autoritetit qendror të shtetit të kërkuar dhe autoritetit të kërkuar.

5. Letërkërkesa përkthehet nga gjykata/prokuroria nëpërmjet përkthyesve të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë, lista e të cilëve u vihet në dispozicion autoriteteve gjyqësore vendase çdo vit nga kjo e fundit.

6. Kur shteti i huaj ka përcaktuar se pranon letërkërkesat në një gjuhë tjetër, gjykata/prokuroria mund ta paraqesë letërkërkesën në gjuhën e pranuar. Në këtë rast, paraqitja e akteve në gjuhën e pranuar nuk prek detyrimet e përkthimit që rrjedhin nga neni 6, paragrafi 3 i germës “a” të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

7. Në rast urgjence apo gjuhe jo shumë të njohur, gjykata/prokurori ia dërgon letërkërkesën dhe aktet Ministrisë së Drejtësisë duke kërkuar që kjo e fundit të procedojë me përkthimin. Kërkesa përmban arsyet e urgjencës apo të pamundësisë për të proceduar me përkthimin në gjuhën jo shumë të njohur.

8. Ministria e Drejtësisë procedon me përkthimin e akteve edhe në rastet e transferimit të një procedimi penal.

9. Shpenzimet e përkthimit në rastet e pikave 5 dhe 6 të këtij udhëzimi evidentohen në mënyrë të detajuar nga Ministria e Drejtësisë dhe i përcillen rast pas rasti gjykatës/prokurorit që ka lëshuar letërkërkesën për t’u përfshirë në shpenzime procedurale të parapaguara, sipas nenit 485 të Kodit të Procedurës Penale.

10. Në rast se Ministria e Drejtësisë konstaton se letërkërkesa nuk plotëson kushtet e lartpërmendura, ia kthen gjykatës/prokurorit, duke treguar saktësisht të metat e konstatuara dhe që duhen plotësuar. Në rastin e një letërkërkesë të paraqitur nga prokurori, ajo i kthehet drejtuesit të prokurorisë së rrethit nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm.

11. Në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja në çështjet penale, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe me legjislacionin në fuqi, veprohet nëpërmjet kanaleve të mëposhtme të komunikimit:

- a) Kanalet diplomatike ose konsullore;
- b) Komunikimi ndërmjet ministrive;
- c) Kanalet e komunikimit të drejtpërdrejtë, ku përfshihet edhe komunikimi përmes Policisë së Shtetit të Republikës së Shqipërisë.

12. Si rregull, letërkërkesa e autoriteteve gjyqësore vendase u përcillet autoriteteve gjyqësore të huaja nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, përveç rastit kur në ligj parashikohet ndryshe.

13. Autoritetet gjyqësore vendase, në raste urgjente, mund t’i përcjellin letërkërkesat drejtpërdrejt tek autoritetet gjyqësore të huaja, me përjashtim të rasteve kur legjislacioni i brendshëm e ndalon një gjë të tillë. Në rast të përcjelljes së letërkërkesës drejtpërdrejt, autoriteti gjyqësor vendas parashtron në letërkërkesë edhe arsyet e urgjencës dhe një kopje e saj i njoftohet njëkohësisht edhe Ministrisë së Drejtësisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Bujar Nishani

PROKURORI I PËRGJITHSHËM
Ina Rama

VENDIM
Nr.48, datë 14.7.2010

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NGA POZICIONET E HAPURA VALUTORE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe të nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 57 pikat 2, 3, 4 dhe 5 dhe të nenit 58 pika 1, shkronja “d” të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore” dhe formularët 1 deri në 7 të saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen rregullorja “Për pozicionet e hapura valutore”, miratuar me vendim nr.59, datë 5.5.1999 të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar, dhe udhëzimi metodik “Për rreziqet nga këmbimet valutore” i datës 26.06.1999.

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NGA POZICIONET E HAPURA VALUTORE

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave dhe kritereve për llogaritjen, raportimin dhe mbikëqyrjen e pozicioneve të hapura valutore të bankave, me qëllim administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3 Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 57 pikat 2, 3, 4 dhe 5 dhe të nenit 58 pika 1, shkronja “d” të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) “Rrezik i kursit të këmbimit” është rreziku i humbjes nga ndryshimi në kursin e këmbimit midis monedhave të ndryshme të huaja dhe/ose ndryshimi në kursin e këmbimit të lekut ndaj monedhave të huaja.

b) “Aktive (të drejta) dhe pasive (detyrime) në monedhë të huaj” janë të gjitha aktivet dhe pasivet të regjistruara në monedhë të huaj.

c) “Pozicion strukturor në valutë” është pozicioni i cili krijohet nga:

i) elemente (zëra të bilancit ose të jashtë bilancit) të cilat nuk janë të natyrës së veprimtarisë (biznesit) kryesore bankare e financiare të bankës dhe/ose janë elemente të qëndrueshme/afatgjata, të tilla si: “interesat në pjesëmarrje”, investimet në “filialet”, “aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara dhe të trupëzuara”, dhurimi i kapitalit për degët e bankës të hapura jashtë vendit etj;

ii) transaksione të bankës, të cilat ruajnë nivelin e mjaftueshmërisë së kapitalit në rastet kur raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ndikohet nga luhatjet e kursit të këmbimit.

KREU II ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË KURSIT TË KËMBIMIT

Neni 5 Mënyra e përcaktimit të pozicioneve të hapura valutore

1. Pozicioni neto i hapur valutor për çdo monedhë të huaj dhe/ose në ar llogaritet si shuma e:

a) pozicionit neto spot, që përcaktohet si diferencë midis aktiveve dhe pasiveve në monedhë të huaj dhe/ose në ar, duke përfshirë dhe interesat e përlllogaritur, si dhe transaksionet spot të cilat kanë të bëjnë me blerje dhe shitje të valutave, për të cilat është rënë dakord, por që nuk janë regjistruar ende në librat kontabël;

b) pozicionit neto forward, që përcaktohet si diferencë midis të gjitha shumave që do të arkëtohen dhe të gjitha shumave që do të paguhën sipas:

i) marrëveshjeve forward për transaksionet e këmbimeve valutore (dhe/ose të arit),

ii) marrëveshjeve future të monedhave të huaja (dhe/ose të arit), si dhe do të përfshijë:

iii) kryegjënë sipas marrëveshjeve swap të monedhave të huaja, të papërfshirë në pozicionin spot, dhe

iv) garancitë e parevokueshme, letrat e kredisë të pambuluara dhe instrumentet e tjera të ngjashme, të cilat janë të sigurta që do të ekzekutohen (*called*) dhe të mundshme për të qenë të parikuperueshme (*irrecoverable*).

c) pozicionit neto të opsioneve të monedhave të huaja (dhe/ose të arit), që përcaktohet si diferencë midis vlerës nominale në total të të gjitha opsioneve *Call* të blera dhe opsioneve *Put* të shitura dhe vlerës nominale në total të të gjitha opsioneve *Put* të blera dhe opsioneve *Call* të shitura.

2. Në llogaritjen e pozicionit të hapur valutor nuk përfshihet pozicioni strukturor në valutë, vetëm pas miratimit nga Banka e Shqipërisë.

3. Pozicioni neto i hapur valutor llogaritet për çdo monedhë të huaj (përfshirë edhe arin) të pasqyruar në bilancin e bankës dhe konvertohet në lekë me kursin zyrtar të publikuar nga Banka e Shqipërisë në ditën e llogaritjes.

4. Pozicioni neto i hapur valutor mund të jetë “pozicion neto i hapur valutor në blerje” (*long*) ose “pozicion neto i hapur valutor në shitje” (*short*).

5. Pozicioni neto i hapur valutor në blerje është kur aktivet në monedhë të huaj janë më të mëdha se pasivet në monedhë të huaj, domethënë kur diferenca midis aktiveve në monedhë të huaj dhe pasiveve në monedhë të huaj është pozitive (me shenjë +).

6. Pozicioni neto i hapur valutor në shitje është kur aktivet në monedhë të huaj janë më të vogla se pasivet në monedhë të huaj, domethënë kur diferenca midis aktiveve në monedhë të huaj dhe pasiveve në monedhë të huaj është negative (me shenjë -).

7. Shuma e të gjitha pozicioneve neto të hapura valutore në blerje, e shprehur në lekë, përfaqëson pozicionin total neto të hapur valutor në blerje.

8. Shuma e të gjitha pozicioneve neto të hapura valutore në shitje, e shprehur në lekë, përfaqëson pozicionin total neto të hapur valutor në shitje.

9. Vlera më e madhe midis pozicionit total neto të hapur valutor në blerje dhe pozicionit total neto të hapur valutor në shitje përfaqëson pozicionin total neto të hapur valutor të bankës, ose ndryshe ekspozimin e përgjithshëm të bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

Neni 6

Kufijtë e lejueshëm për pozicionet e hapura valutore

1. Pozicioni total neto i hapur valutor i bankës në fund të çdo dite pune nuk duhet të kalojë 30 (tridhjetë) për qind të kapitalit të saj rregullator.

2. Pozicioni neto i hapur valutor i bankës në çdo monedhë të huaj dhe/ose në ar në fund të çdo dite pune nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) për qind të kapitalit të saj rregullator.

Neni 7

Administrimi i rrezikut nga pozicionet e hapura valutore

1. Banka krijon sistemin e administrimit të rrezikut të kursit të këmbimit ndaj të cilit ajo ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, me qëllim identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e këtij rreziku.

2. Banka harton politika dhe procedura të nevojshme për administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit.

3. Politika për administrimin e rrezikut nga kursi i këmbimit përfshin minimalisht:

a) objektivat dhe parimet e bankës në ushtrimin e veprimtarive në monedhë të huaj;

b) kufizime të qarta dhe të sakta për ekspozimin e bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, në përputhje me kufijtë e lejueshëm të përcaktuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje;

c) përcaktime të qarta të përgjegjësisë dhe delegimit të tyre në lidhje me aktivitetet në monedhë të huaj, si dhe të njësive organizative dhe personave për administrimin e rrezikut nga kursi i këmbimit;

d) përjashtimet e mundshme nga kufijtë/kufizimet e brendshme të përcaktuara dhe përgjegjësitë për marrjen e vendimeve për aplikimin e këtyre përjashtimeve.

4. Politika për administrimin e rrezikut nga kursi i këmbimit duhet të jetë në përputhje me natyrën, qëllimin, tipin dhe kompleksitetin e veprimtarive në monedhë të huaj të cilat banka i kryen dhe/ose planifikon t'i kryejë.

5. Këshilli drejtues i bankës miraton politikën e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni dhe e rishikon atë të paktën një herë në vit për ndryshime dhe/ose përmirësime të mundshme.

6. Banka vlerëson dhe monitoron rrezikun e kursit të këmbimit çdo ditë.

7. Komiteti/struktura e administrimit të rreziqeve minimalisht:

- a) zbaton politikën e administrimit të rrezikut të kursit të këmbimit;
- b) jep sugjerime për përmirësimin e politikës së administrimit të rrezikut të kursit të këmbimit;
- c) vlerëson sistemin e bankës për administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit;
- d) përcakton kufij të brendshëm për raportet midis pozicioneve të hapura valutore për monedha të ndryshme (*long* dhe *short*) dhe kapitalit rregullator, dhe i shqyrton në mënyrë periodike këto raporte;
- e) kryen analiza për ekspozimin e bankës ndaj kursit të këmbimit dhe monitoron veprimtarinë për administrimin e këtij rreziku;
- f) analizon ndikimin e administrimit të rrezikut të kursit të këmbimit në rezultatet e operacioneve të bankës nëpërmjet skenarëve të ndryshëm apo rezultateve të stress-test-eve;
- g) monitoron kushtet makroekonomike dhe kushte të tjera (të brendshme dhe të jashtme), të cilat kanë ndikim në kursin e këmbimit dhe që e ekspozojnë bankën ndaj rrezikut të veprimtarisë në monedhë të huaj, me qëllim identifikimin në kohë të këtyre rreziqeve dhe marrjen e masave për administrimin e tyre.

8. Drejtoria e bankës minimalisht:

- a) harton dhe aplikon procedura për identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e rrezikut të kursit të këmbimit të bankës në përputhje me politikën për administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit;
- b) krijon dhe aplikon sisteme të përshtatshme për matjen e ekspozimit të bankave ndaj rrezikut të kursit të këmbimit;
- c) krijon dhe aplikon sisteme të përshtatshme për monitorimin dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve nga aktivitetet në monedhë të huaj;
- d) përcakton kushtet dhe termat për monitorimin dhe vlerësimin mbi baza të rregullta të politikës dhe zbatimit të saj;
- e) harton procedura për vlerësimin e ndikimit të produkteve të reja në ekspozimin ndaj rrezikut të kursit të këmbimit;
- f) monitoron kushtet ekonomike dhe kushte të tjera në të cilat banka është duke vepruar, me qëllim përballimin e ndryshimeve eventuale në aktivitetet në monedha të huaja, kursin e këmbimit dhe rrezikun e ekspozimit të monedhës/ave;
- g) përgatit dhe sugjeron forma, përmbajtje dhe metoda për raportim në këshillin drejtues dhe komitetin e administrimit të rreziqeve për aktivitetet në monedhë të huaj, për administrimin eficient të rrezikut të kursit të këmbimit, ndaj të cilit banka është e ekspozuar.

9. Në rastet kur banka është subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar, politika për administrimin e rrezikut nga kursi i këmbimit përfshin administrimin e rrezikut nga kursi i këmbimit në nivel grupi bankar.

10. Procedurat për zbatimin e politikës për administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit përfshijnë minimalisht:

- a) raportimin tek drejtoria dhe këshilli drejtues të:
 - i) pozicioneve të hapura valutore sipas monedhave;
 - ii) pozicionit valutor total;
 - iii) fitimit dhe humbjes së realizuar nga veprimtaria në monedhë të huaj.
- b) sisteme kontrolli në:
 - i) njësitë e përcaktuara për të kryer dhe administruar veprimtaritë në monedhë të huaj;
 - ii) monitorimin e përputhshmërisë dhe respektimit të kufijve të përcaktuar për ekspozimin ndaj rrezikut të kursit të këmbimit;
 - iii) regjistrimin e transaksioneve që kanë lidhje me veprimtarinë e bankës në monedhë të huaj.
- c) metodologjinë e kryerjes së stress test-it për ekspozimin e bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, në përputhje me procedurat e brendshme të bankës.

KREU III
MBIKËQYRJA DHE RAPORTIMI

Neni 8

Kërkesa monitoruese dhe mbikëqyrëse

1. Bankat detyrohen të njoftojnë menjëherë në Bankën e Shqipërisë, për çdo rast të tejkalimit të kufizimeve të lejueshme të pozicionit/eve të hapur/a valutor/e, të përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje. Me këtë njoftim banka i paraqet Bankës së Shqipërisë kohën dhe masat e nevojshme për rivendosjen e pozicioneve të hapura valutore brenda kufijve të lejueshëm.

2. Kuadri i përgjithshëm i procedurave administrative dhe kontabël, si dhe i sistemeve të informacionit në lidhje me identifikimin, regjistrimin dhe monitorimin e pozicioneve të hapura valutore, janë subjekt i mbikëqyrjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm nga Banka e Shqipërisë.

Neni 9

Raportimi në Bankën e Shqipërisë

1. Bankat plotësojnë dhe dorëzojnë në Bankën e Shqipërisë, në fund të çdo muaji, formularët përkatës të kësaj rregulloreje, si pjesë e Sistemit Raportues të Unifikuar.

2. Formularët 1,2,3,4 dhe 7 pasqyrojnë llogaritjet e pozicionit neto të hapur valutor të bankës në zbatim të kërkesave të nenit 6 të kësaj rregulloreje, ndërsa formularët 5 dhe 6 plotësojnë kërkesat mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë për nevoja të monitorimit të pozicionit neto të hapur valutor të bankës duke konsideruar të gjithë zërat jashtë bilancit.

3. Grupi bankar raporton mbi baza të konsoliduara për pozicionet e hapura valutore, çdo 3 (tre) muaj. Ky raportim kryhet sipas formularëve të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

4. Departamenti i Mbikëqyrjes, në çdo rast që e gjykon të arsyeshme, ka të drejtë të kërkojë nga bankat ndryshime në përmbajtjen dhe në shpeshhtësinë e raportimit.

Neni 10

Masat mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë, në rast të mosrespektimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse të parashikuara në ligjin nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

KREU IV
TË FUNDIT

Neni 11

Dispozitë kalimtare

Bankat janë të detyruara të kryejnë rishikimin dhe miratimin e rregulloreve dhe procedurave të brendshme për vlerësimin dhe monitorimin e pozicioneve të hapura valutore në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje jo më vonë se 3 (tre) muaj pas hyrjes në fuqi të saj.

Formulari 1

POZICIONI SPOT NË VALUTË					
A. Aktiv					
	USD	EURO		AR	TOTALI
1. Arka dhe Banka Qendrore					
2. Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për refinancim me Bankën Qendrore					
3. Llogari rrjedhëse në banka, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare					
4. Depozita në banka, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare					
pa afat					
me afat					
5. Huadhënie bankave, institucioneve të kreditit dhe institucioneve të tjera financiare					
6. Të tjera me bankat, institucionet e kreditit dhe institucione të tjera financiare					
7. Hua dhe paradhënie					
afatshkurtër					
afatmesme					
afatgjatë					
minus provigjonet për kreditë					
8. Detyrime të klientëve për llogaritë rrjedhëse					
9. Bono dhe letra të tjera me vlerë me të ardhura fikse					
10. Bono dhe letra të tjera me vlerë me të ardhura të ndryshueshme					
11. Interesa pjesëmarrës					
në banka dhe institucione financiare					
në të tjera					
12. Mjete të qëndrueshme të patrupëzuara (neto) (minus amortizimin)					
13. Mjete të qëndrueshme të trupëzuara (neto) (minus amortizimin)					
14. Të tjera aktive					
Totali i Aktivit					
15. Transaksione valutore- blerje valute spot					
Pozicioni Spot në Aktiv (Totali i aktivitetit dhe i transaksioneve valutore -blerje valute spot)					
Pozicioni Spot në Aktiv (kundërvlera në milionë lekë)					
B. Pasivi					
	USD	EURO	...	AR	TOTALI
1. Banka Qendrore					
2. Llogari rrjedhëse nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare					
3. Llogari rrjedhëse në banka, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare					
4. Depozita nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare					
pa afat					
me afat					
5. Hua marrë nga bankat, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare					
6. Detyrime ndaj klientëve për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat					
depozita					
7. Detyrime ndaj Qeverisë Shqiptare dhe administratës publike					
8. Detyrime nga bonot dhe letra të tjera me vlerë					
minus provigjonet për kreditë					
9. Ndihma dhe financime publiku					
10. Fonde rezervë specifike					
11. Borxhi i varur					
12. Kapitulli i aksionerëve					

kapitali i paguar					
primet					
13. Të tjera detyrime					
T o t a l i i P a s i v i t					
14. Transaksione valutore - shitje valute spot					
Pozicioni Spot në Pa s i v (Totali i pasivit dhe i transaksioneve valutore -shitje valute spot)					
Pozicioni spot në Pa s i v (kundërvlera në lekë)					

Formulari 2

POZICIONI FORWARD NË VALUTË					
C. Pozicioni në blerje (LONG)	USD	EURO	...	AR	TOTALI
1. Transaksione valutore - blerje valute forward					
2. Transaksione valutore - blerje valute future					
3. Transaksione valutore - kryegjëja sipas marrëveshjeve swap (pjesa e papërfshirë në pozicionin spot)					
4. Garancitë sipas përcaktimit të rregullores					
5. Letër kreditë sipas përcaktimit të rregullores					
Pozicioni forward në blerje (LONG)					
Pozicioni forward në blerje (LONG) (kundërvlera në milionë lekë)					
D. Pozicioni në shitje (SHORT)	USD	EURO	...	AR	TOTALI
1. Transaksione valutore - shitje valute forward					
2. Transaksione valutore - shitje valute future					
3. Transaksione valutore - kryegjëja sipas marrëveshjeve swap (pjesa e papërfshirë në pozicionin spot)					
4. Garancitë sipas përcaktimit të rregullores					
5. Letër kreditë sipas përcaktimit të rregullores					
Pozicioni forward në shitje (SHORT)					
Pozicioni forward në shitje (SHORT) (kundërvlera në milionë lekë)					

Formulari 3

POZICIONI NETO I OPSIONEVE	USD	EURO	...	AR	TOTALI
1. Blerje opsioni <i>CALL</i>					
2. Shitje opsioni <i>PUT</i>					
3. Shitje opsioni <i>CALL</i>					
4. Blerje opsioni <i>PUT</i>					
Pozicioni neto i opsioneve (1+2)-(3+4)					
Pozicioni neto i opsioneve (kundërvlera në milionë lekë)					

Formulari 4

POZICIONET E HAPURA VALUTORE	Pozicioni SPOT		Pozicioni FORWARD		Pozicioni neto i hapur valutore (pa përfshirë OPSIONET)	Pozicioni neto i OPSIONEVE	Pozicioni neto i hapur valutore (duke përfshirë OPSIONET)	Kursi i këmbimit	Ekuivalenti në Lek i pozicionit neto të hapur valutore	Pozicioni neto i hapur valutore në lek / Kapitalit rregullator
	Mjetet	Detyrimet	Pozicioni në blerje (long)	Pozicioni në shitje (short)						
Monedha	(2)	(3)	(4)	(5)	(6) = (2) - (3) + (4) - (5)	(7)	(8) = (6) + (7)	(9)	(10)	(11) = (10) / (15) * 100
USD										
EURO										
GBP										
CHF										
CAD										
SEK										
AUD										
JPY										
DKK										
NOK										
TRY										
AR										
1. Pozicioni total neto i hapur valutore në blerje (12)										
2. Pozicioni total neto i hapur valutore në shitje (13)										
3. Pozicioni total neto i hapur valutore i bankës (14) = (12) nqs (12) > (13); ose (13) nqs (13) > (12)										
4. Kapitali rregullator (15)										
5. Pozicioni total neto i hapur valutore i bankës (14)/kapitalit rregullator (15)*100 = < (30%)										
Norma e miratuar për një monedhë										20%
Norma e miratuar për të gjitha monedhat së bashku										30%

Formulari 5

Zërat jashtë bilancit (pa elementet e përfshira në pozicionet SPOT, FORWARD dhe Opsionet)	USD	EURO	...	AR	TOTALI
F. A k t i v i					
1. Angazhime financimi të dhëna në favor të bankave dhe institucioneve financiare në favor të klientëve					
2. Garanci të dhëna në favor të bankave dhe institucioneve financiare në favor të klientëve					
3. Angazhime për letra me vlerë për t'u marrë					
4. Letra me vlerë të dhëna si garanci për një kredi ose refinancim					
5. Letra me vlerë të marra hua					
6. Angazhime të tjera					
7. Angazhime për instrumente financiare të dhëna					
Totali i zërave jashtë bilancit të aktivit					
Totali i zërave jashtë bilancit të aktivit (kundërvlera në milionë lekë)					
G. P a s i v i	USD	EURO	CHF	AR	TOTALI
1. Angazhime financimi të marra nga bankat dhe institucionet e kreditit nga klientët					
2. Garanci të marra nga bankat dhe institucionet e kreditit nga klientët					
3. Angazhime për letra me vlerë për t'u dhënë					
4. Letra me vlerë të marra si garanci për një kredi ose refinancim					
5. Letra me vlerë të dhëna hua					
6. Angazhime të tjera					
7. Angazhime për instrumente financiare të marra					
Totali i zërave jashtë bilancit të pasivit					
Totali i zërave jashtë bilancit të pasivit (kundërvlera në milionë lekë)					
H) Zërat jashtë-bilancit neto (kundërvlera në milionë lekë) (F-G)					

Formulari 6

POZICIONET E HAPURA VALUTORE	Ekuivalenti në Lek i pozicionit neto të hapur valutës	Zërat jashtë-bilancit neto	Pozicioni total përfshirë zërat e tjerë jashtë-bilancit	Pozicioni neto i hapur valutës në lek/kapitalit rregullator
Monedha				
(1)	(2)	(3)	(4) = (2) + (3)	(5)=(4)/(7)*100
USD				
EURO				
GBP				
CHF				
CAD				
SEK				
AUD				
JPY				
DKK				
NOK				
TRY				
AR				
1. Pozicioni total neto i hapur valutës në blerje (6)				
2. Pozicioni total neto i hapur valutës në shitje (7)				
3. Pozicioni total neto i hapur valutës i bankës (8)= (6) nqs (6)>(7); ose (7) nqs (7)>(6)				
4. Kapitali rregullator (7)				
5. Pozicioni total neto i hapur valutës i bankës (8)/kapitalit rregullator (7)*100				

Shënime sqaruese:
Kolona (2): Formulari 4, kolona (10).
Kolona (3): Formulari 5, shkronja (H).

Formulari 7

Elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e pozicionit të hapur valutës	USD	EURO	...	AR

Shënime sqaruese:
Formulari 7 plotësohet nga banka sipas përcaktimeve të rregullores.

VENDIM
Nr.49, datë 14.7.2010

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE SHITESË
NGA BANKA RAIFFEISEN SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronjat “c” dhe “e”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar; të nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të nenit 54, pika 2, shkronja “dh”, nënpikat v, vi, vii dhe shkronja “ë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për kryerjen nga Banka Raiffeisen sh.a. të veprimtarive financiare shtesë, si më poshtë:

a) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetëorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:

- i) letra me vlerë të transferueshme;
- ii) instrumente të tjera të negociueshme dhe aktive financiare, duke përfshirë veprimet me arin;
- iii) pjesëmarrjen në emetimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, duke përfshirë nënshkrimin dhe vendosjen si agjent (si publik, ashtu edhe privat) dhe kryerjen e shërbimeve lidhur me këto emetime.

b) Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e përfshira në licencën e dhënë nga Banka e Shqipërisë, duke përfshirë referencën e kredisë dhe të analizës, kërkimin dhe këshillimin në lidhje me investimet dhe portofolin, si dhe këshillimin mbi blerjet e mbi strategjinë dhe ristrukturimin e shoqërive”.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës të Bankës Raiffeisen sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani

KËRKESË
Nr.326/1, datë 21.1.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e Re Tiranë” (Fabrika e Bukës – Doganë).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë që kjo shpallje kërkesë për shpronësim bëhet vetëm për pasurinë e llojit tokë arë dhe truall.

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Pretendues, zgjidhje pronësie, plotësim dokumentacioni, rikonfirmim”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues, në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është, tokë truall me sipërfaqe 3834 m² dhe tokë arë me sipërfaqe 32285 m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi tokë “truall dhe arë”, 119 467 251 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E SHPRONËSIMIT PER SEGMENTIN RRUGOR UNAZA E RE TIRANE (FABRIKA E MIELLIT - DOGANA)

NR	Emri	Atesia	Mbiemri	Zona	Nr.	Sip.	Sip	Toke are	Vlera	Toke truall	Çmimi	Vlera	VLERA	Shenime
				kad.	pas.	(m ²)	(m ²)	çmimi (m ²)	(leke)	Sip (m ²)	(m ²)	(leke)	(leke)	
1	Pretendues Trashgimtare	Lagami		3866	215/50	4980	4727	297	1403919				1403919	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
2	Pretendues Trashgimtare	Llagami		3866	301/58	6260	5256	297	1561032				1561032	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
3	Pretendues B. Pronaret	Cerri		3866	305/53	150	150	297	44550				44550	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
4	Pretendues Pellumb		Nurja	3866	305/55	491	491	297	145827				145827	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
5	Pretendues Sali		Avdillari	3866	305/59	662	662	297	196614				196614	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
6	Pretendues Qemal		Haxhiu	3866	305/69	926	926	297	275022				275022	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
7	Pretendues Luan		Ferraj	3866	305/72	975	975	297	289575				289575	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
8	Pretendues Beqir		Shaqiraj	3866	305/75	1060	1060	297	314820				314820	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
9	Pretendues Qerim		Avdillari	3866	305/78	500	500	297	148500				148500	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
10	Pretendues Arben		Meta	3866	305/81	500	500	297	148500				148500	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
11	Pretendues Qemal		Beqiri	3866	305/83	740	740	297	219780				219780	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
12	Pretendues Shaban		Bacelli	3866	306/143	780	780	297	231660				231660	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
13	Pretendues Enver		Dajti	3866	306/146	1130	1130	297	335610				335610	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
14	Pretendues Xhavit		Dajti	3866	306/149	990	990	297	294030				294030	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
15	Pretendues Olsi		Ahazi	3866	306/153	192	192	297	57024				57024	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
16	Pretendues Bexhet		Fidani	3866	306/156	584	584	297	173448				173448	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
17	Pretendues Bexhet		Mujollari	3866	306/203	1125	1125	297	334125				334125	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
18	Pretendues Hamdi		Bixhaku	3866	306/205	630	630	297	187110				187110	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
19	Pretendues Mynyr		Ahmeti	3866	315/35	1272	1272	297	377784				377784	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
20	Pretendues Selim		Ahmeti	3866	315/37	1325	1325	297	393525				393525	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.

21	Pretendues Menafi		Killo	3866	315/41	596	596	297	177012				177012	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
22	Pretendues Ismet		Mustafa	3866	315/44	596	596	297	177012				177012	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
23	Pretendues Selman		Dumi	3866	315/53	654	654	297	194238				194238	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
24	Pretendues Sokol		Xhixhabesi	3866	315/56	1006	1006	297	298782				298782	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
25	Pretendues Shadije Maringlen		Dedja	3866	315/58	2384	2384	297	708048				708048	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
26	Pretendues Arjan		Gjonaj	3866	315/61	1218	1218	297	361746				361746	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
27	Pretendues Fatmir		Avdiaj	3866	315/63	476	476	297	141372				141372	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
28	Pretendues Xhemal		Shaqiri	3866	315/65	70	70	297	20790				20790	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
29	Pretendues B. Pronaret	Avdillari		3866	315/75	1270	1270	297	377190				377190	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
30	Pretendues Trashgimtare	Shijaku		8210	7/259	4088				3834	28659	109878606	109878606	Rikonfirmim, Saktesim pronesie,Plotesim dok.
	SHUMA												119467251	
	SHUMA						32285		9588645	3834		109878606	119467251	

KËRKESË
Nr.4086, datë 6.7.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private tokë arë dhe truall, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By pass Plepa-Kavajë Rrogozhinë” lotet 6,7.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Në numrin 6 rendor të listës me shënimin “Konflikt pronësie”, pronari është i papërcaktuar për shkak të pretendimit të pronësisë nga dy persona të ndryshëm, për këtë arsye kërkohet rikonfirmim nga ZRPP Kavajë. Lidhur me numrin 8 rendor të listës “Rikonfirmim”, rikërkohet rikonfirmim pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Kavajë, për shkak të të dhënave të paqarta. Për dy pasuritë, për të cilat është bërë shënimi “I pakonfirmuar”, pronarët të cilët pretendojnë pronësinë duhet të aplikojnë pranë zyrës së regjistrimit për regjistrimin e tyre, pasi në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 22 152 297 (njëzet e dy milionë e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRIA PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA SHPRONËSIMEVE

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I BY-PASS "PLEPA-KAVAJË-RROGOZHINË"
Loti 6 (tokat)

Nr.	Pronari			Zona kad.	Nr /pas	Sip. m2	Lloji Pasurise	Çmimi	Vlera	Shenime
	Emri	Atesia	Mbiemri							
1	Mehmet		Dedej	3204	94/2	280	are	351	98280	konfirmuar nga ZVRPP
2	Hatlije		Dedej	3204	94/3	145	are	351	50895	konfirmuar nga ZVRPP
3	Lumturi		Biturku	8551	1/7	158	truall	15000	2370000	konfirmuar nga ZVRPP
4	Limane		Kollcaku	8551	1/6	158	truall	15000	2370000	konfirmuar nga ZVRPP
5	Rifat		Kollcaku	8551	1/5	154	truall	15000	2310000	konfirmuar nga ZVRPP
6	Pronar i papërcaktuar			8551	1/27	291	truall	15000	4365000	Konflikt pronesie
7	Arben		Shehi	8551	1/250	264	truall	15000	3960000	konfirmuar nga ZVRPP
8	Tahir		Guga	8551	1/253	214	truall	15000	3210000	Rikonfirmim
9	Ramazan		Tatani	8551	1/23	13	truall	15000	195000	konfirmuar nga ZVRPP
10	Ramazan		Tatani	8551	1/21	127	truall	15000	1905000	konfirmuar nga ZVRPP
11	Islam		Dedja	3204	64/14	77	are	351	27027	konfirmuar nga ZVRPP
12	Islam		Dedja	3204	64/23	37	are	351	12987	konfirmuar nga ZVRPP
13	Ali		Tatani	3204	64/24	70	are	351	24570	konfirmuar nga ZVRPP
14	I paidentifikuar			3204	61/14	92			0	i pakonfirmuar
15	B/Pr Tatani			3204	65/5	31	are	351	10881	konfirmuar nga ZVRPP
16	I paidentifikuar			3204	65/4	13			0	i pakonfirmuar
	SHUMA					2124			20909640	

MINISTRIA PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA SHPRONËSIMEVE

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I BY-PASS "PLEPA-KAVAJË-RRGOZHINË"
Loti 7 (tokat)

Nr.	Pronari			Zona kad.	Nr /pas	Sip. m2	Lloji Pasurise	Çmimi	Vlera	Shenime
	Emri	Atesia	Mbiemri							
1	Bujare		Biturku	8552	1/153	55	truall	14800	814000	konfirmuar nga ZVRPP
2	Agron		Elezi	8552	10/50	9	truall	14800	133200	konfirmuar nga ZVRPP
3	Xhavit		Kollcaku	8552	10/232	23	are	359	8257	konfirmuar nga ZVRPP
4	Jakup		Kollcaku	8552	10/62	201	are	359	72159	konfirmuar nga ZVRPP
5	Muharrem		Kollcaku	8552	10/60	112	are	359	40208	konfirmuar nga ZVRPP
6	Sulejman		Allajbej	8552	12/287	96	are	359	34464	konfirmuar nga ZVRPP
7	Sulejman		Allajbej	8552	12/289	84	are	359	30156	konfirmuar nga ZVRPP
8	Sulejman		Allajbej	8552	12/290	103	are	359	36977	konfirmuar nga ZVRPP
9	Sulejman		Allajbej	8552	12/291	89	are	359	31951	konfirmuar nga ZVRPP
10	Sulejman		Allajbej	8552	12/292	65	are	359	23335	konfirmuar nga ZVRPP
11	Hasan		Allajbej	8552	12/257	50	are	359	17950	konfirmuar nga ZVRPP
	SHUMA					887			1242657	

KËRKESË
Nr.3816/2, datë 9.7.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë, truall dhe objekte) që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Porto Romano-Durrës”, loti i parë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Për të gjithë pronarët që pretendojnë pronësinë përkatëse të truallit dhe objektit, do të rikërkohet konfirmim pranë ALUIZNI-t.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 177 248 681 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS
"Porto Romano - Durrës", loti parë

NR	Emri	Atesia	Mbiemri	Zona kadast.	Nr. pasurise	Siperf pergj.m2.	LLOJI I PASURISE					SHUMA (Leke)	Shenime
							M ²	TRUALL Çmimi	Vl. (Leke)	OBJEKT(Lloji)	Vl. (Leke)		
1	Rifat	Rustem	Hoxha	8517	152/4	411	384	3600	1382400	banese 1kt	4739903	6122303	Rikonf. ALUIZNI
2	Qemal	Murat	Allamani	8517	152/2	487	223	3600	802800	banese 1kt	2053652	2856452	Rikonf. ALUIZNI
3	Baki	Fadil	Shenjtari	8517	152/93	386	122	3600	439200	banese 2kt	5526174	5965374	Rikonf. ALUIZNI
4	Skender	Hasan	Pepa	8517	152/25	381	255	3600	918000	banese 1kt	3761997	4679997	Rikonf. ALUIZNI
5	Tofik	Zenel	Bershini	8517	152/81	329	271	3600	975600	banese 1kt	3592437	4568037	Rikonf. ALUIZNI
6	Enver	Zenel	Bershini	8517	152/78	183	180	3600	648000	banese 1kt	2045952	2693952	Rikonf. ALUIZNI
7	Rifat	Bajram	Dibra	8517	152/199	448	188	3600	676800	banese 1kt	7671850	8348650	Rikonf. ALUIZNI
8	Ahmet	Hasan	Pisli	8517	152/46	512	286	3600	1029600	banese 1kt	3153007	4182607	Rikonf. ALUIZNI
9	Dritan	Izet	Hysa	8517	152/219	400	400	3600	1440000	banese 1kt	128008	1568008	Rikonf. ALUIZNI
10	Xhevdet	Hajredin	Kutriqi	8517	152/45	517	512	3600	1843200	banese 1kt	4333531	6176731	Rikonf. ALUIZNI
11	Leonard	Xhevdet	Kutriqi	8517	152/44	295	184	3600	662400	banese 1kt	257087	919487	Rikonf. ALUIZNI
12	Nezir	Hasan	Pepa	8517	152/27	439	421	3600	1515600	banese 1kt	4569924	6085524	Rikonf. ALUIZNI
13	Flamur	Vehap	Uka	8517	152/220	218	218	3600	784800	banese 2kt	9674245	10459045	Rikonf. ALUIZNI
14	Zeqir	Selam	Parllaku	8517	152/239	318	318	3600	1144800	banese 1kt	3520725	4665525	Rikonf. ALUIZNI
15	Ahmrt	Adem	Tufa	8517	152/243	294	294	3600	1058400	banese 1kt	3833594	4891994	Rikonf. ALUIZNI
16	Lavdrim	Rakip	Pisli	8517	152/62	210	210	3600	756000	banese 1kt	440811	1196811	Rikonf. ALUIZNI
17	Haxhi	AvdyI	Mulgeci	8517	152/198	304	304	3600	1094400	banese 1kt	4126312	5220712	Rikonf. ALUIZNI
18	Faik	Halil	Metra	8517	152/76	237	237	3600	853200	banese 1kt	218091	1071291	Rikonf. ALUIZNI
19	Hamide	Zenel	Kurmeta	8517	152/94	480	148	3600	532800	banese 1kt	4842343	5375143	Rikonf. ALUIZNI
20	Haxhi	Mehmet	Dunisha	8517	152/197	304	236	3600	849600	banese 1kt	3970400	4820000	Rikonf. ALUIZNI
21	Uke	Rustem	Sula	8517	152/202	476	475	3600	1710000	banese 1kt	3467360	5177360	Rikonf. ALUIZNI
22	Oltjana	Sahit	Memaj	8517	152/296	397	91	3600	327600	banese 1kt	5000784	5328384	Rikonf. ALUIZNI
23	Ali	Zenel	Bershini	8517	152/83	430	250	3600	900000	banese 1kt	2096467	2996467	Rikonf. ALUIZNI
24	Ibrahim	Xhetan	Kalia	8517	152/96	286	282	3600	1015200	banese 1kt	2267753	3282953	Rikonf. ALUIZNI
25	Sulejman	Man	Topalli	8517	152/157	496	202	3600	727200	banese 1kt	2881425	3608625	Rikonf. ALUIZNI
26	Urim	Jaxha	Kolliqi	8517	152/95	417	421	3600	1515600	banese 1kt	4261741	5777341	Rikonf. ALUIZNI
27	Veze	Myftar	Kalia	8517	152/97	314	106	3600	381600	banese 1kt	3845478	4227078	Rikonf. ALUIZNI
28	Shpetim	Aqif	Aliaj	8517	152/21	301	142	3600	511200	banese 1kt	239023	750223	Rikonf. ALUIZNI
29	Riza	Rustem	Huna	8517	152/138	300	300	3600	1080000	banese 1kt	3730765	4810765	Rikonf. ALUIZNI
30	Selim	Zenel	Gjedia	8517	152/180	341	341	3600	1227600	banese 1kt	4228039	5455639	Rikonf. ALUIZNI
31	Ymer	Zenel	Gjedia	8517	152/179	275	275.5	3600	991800	banese 1kt	3631344	4623144	Rikonf. ALUIZNI
32	Isuf	Halil	Katraroshi	8517	152/178	198	189	3600	680400	banese 1kt	3080292	3760692	Rikonf. ALUIZNI
33	Qemal	Avdi	Kurti	8517	152/237	300	300	3600	1080000	banese 1kt+ 1	3919152	4999152	Rikonf. ALUIZNI
34	Hajredin	Nazif	Miha	8517	152/134	517	515	3600	1854000	banese 1kt	2757638	4611638	Rikonf. ALUIZNI
35	Aranit	Rasim	Sokoli	8517	152/282	242	144	3600	518400	banese 1kt	197627	716027	Rikonf. ALUIZNI
36	Gezim		Prendi	8517	152/155		298	3600	1072800	banese 1kt	2503223	3576023	Rikonf. ALUIZNI

37	Mark		Biba	8517	152/297	422	422	3600	1519200	banese 1kt	2263324	3782524	Rikonf. ALUIZNI
38	Petrit	Nazir	Kola	8517	152/113	431	6	3600	21600	banese 1kt	2107327	2128927	Rikonf. ALUIZNI
39	Hasime	Shpend	Shkreli	8517	152/175	299	211	3600	759600	banese 1kt	1411947	2171547	Rikonf. ALUIZNI
40	Fatos	Adem	Kadiu	8517	152/64	272	76	3600	273600	banese 1kt	1821246	2094846	Rikonf. ALUIZNI
41	Hamdi	Ramazan	Alliu	8517	152/260	423	259	3600	932400	banese 1kt	2017142	2949542	Rikonf. ALUIZNI
42	Fatmir	Minush	Dajci	8517	152/181	166	10	3600	36000	banese 2kt	5199531	5235531	Rikonf. ALUIZNI
43	Shkelzen		Mehaj	8517	152/253	224	39	3600	140400			140400	Rikonf. ALUIZNI
44	Hysni		Shahini	8517	152/237	477	32	3600	115200			115200	Rikonf. ALUIZNI
45	Hasan		Ceka	8517	152/118	320.8	320.8	3600	1154880	banese 1 kt	1906130	3061010	Rikonf. ALUIZNI
	Shuma						11098		39953880		137294801	177248681	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 4.8.2010

Doli nga shtypi më 6.8.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë